

85H-32

M 99

Faruk
Myrtaj



ATA
QE KAM
NJOHUR

TREGIME


81H-32

1477

Faruk Myrtaj

**Ata
që kam
njohur**

tregime



SHTËPIA BOTUESE
«NAIM FRASHËRI»

MARKISTI

Ai zakonisht rri aty, mbi grykën e galerisë horizontale. Ka shtruar mbi armaturën ca fier, e ka lidhur me zhukë, duke formuar kështu një si shilte. Aty ulet.

Të tjerët lëvizin pa pushim poshtë. Nxitojnë pas vagonëve, djersijnë, flasin me njëri-tjetrin, qeshin, hyjnë e dalin te gryka e galerisë, shkojnë gjer te fusha e shkarkimit dhe kthehen përsëri. Të tjerët punojnë.

«Kurse unë jam kot», i thotë ai vetes.

E mban bllokun mbi gjunjë, lapsin e ka varur lidhur me një fill spango në brezin e pantallonave. Për çdo vagon që del te gryka e galerisë, aty poshtë këmbëve të tij, ai shënon një vijë në bllok. Heq një vijë, një shenjë, prandaj i thonë markist, njeri që vë shenjat. Kërkon në bllok emrin e vagonistit që del me vagon dhe në kolonën e radhën përkatëse shënon një vijë.

Këtë punë bën, Pazaiti, markisti.

«Këtë e bën edhe një fëmijë...» vazhdon të flasë me vete. S'di ç'të bëjë, me kë të flasë...

— Ej, Pazo, shënoje, mineral! — i thërret vagonisti që del nga gryka.

— T'u bënë tetë vagonë! — i përgjigjet markisti.

— Sa të duash e sa të thuash ti janë!

— Jo sa të them unë, jo! Aq sa do të nxjerrin duart e tua, aq do të shënojë ky lapsi im i vogël në bllok.

Pazaiti flet fare i qetë. Sikur as ka kuptuar e as do të kuptojë përse vagonisti flet ashtu. Sikur ka harruar fare se pak ditë më parë ai i ka dërguar një çantë të mbushur me fruta në shtëpi. Pazoja ia kishte kthyer, po të nesërmen nuk i kishte thënë asgjë.

Vagonisti qesh ngadalë me vete dhe i mëshon vagonit. «Me këtë s'di si të flasësh, — thotë për markistin. — As ashtu e as kështu! Çfarë njeriu është!»

Merr vagonin bosh e hyn përsëri në galeri. Markisti e vështron nga sipër duke qeshur e duke i tundur kokën. «S'është i keq, jo, si punëtor edhe si njeri, po ç't'i bësh kërrabës, nga vetja tërheq!» mendon për vagonistin.

Ulet mirë te shiltja prej fieri.

Nga zyrat vjen Leçoja, i dobët dhe i gjatë, pakëz i kërrusur, me flokë të shkurtër fare e të thinjur. Për ta shohësh tani, nuk thua dot se ç'flokë ka pasur më parë, biondë apo të zinj, gështenjë apo ka lindur ashtu siç është, i thinjur.

Leçoja zëvendëson përgjegjësit e ndërrësive kur ata bëjnë pushimet. Këto ditë ai ndryshohet krejt. Sikur nuk kërruset, sikur i vetë-

tijnë sytë si të një njëzetepesëvjeçari e jo të lodhur e të përgjumur, të një tridhjetëepesëvjeçari, sa është në të vërtetë.

Kur është punëtor, ka vetëm një dobësi. Ai vetë nuk e fsheh këtë. Mbaron normën dhe, hëni, u thotë këmbëve del te gryka, fut çekiçin te dollapi i sajuar me fletë hekuri, që i thonë kasafortë dhe prapë, hëni, këmbëve e në shtëpi. Pa leje! Le të grindet përgjegjësi, të presë orët e ditës, së punës, or po le të bëjë ç'të dojë, Leçoja ikën! S'e mban dot gjer në fund të tetorëshit, sidomos kur punon në ndërresën e dytë dhe televizori jep ndonjë ndeshje futbollit! Hajde kape Leçon...! Kur është punëtor ndodh kjo. Sot është përgjegjës. Markisti e sheh që po vjen dhe e di që do të kapet me dikë, do t'i mbërthejë qetë me ndonjë, kështu e ka Leçoja!

Pazaiti s'i ka qejf llafet. Oh, llafet! Ato ta hanë shpirtin, si mola, dalëngadalë, pa zhurmë, or po si ai lumi që gërryen brigjet e tij! Markisti ndien vagonin që po del te gryka. Nga zhurma beson se ai është Veri. Veri është flori, thotë Pazoja për të, s'qan vagoni i Verit, i mbush plot ai. S'ka ç'të thotë Leçoja, përgjegjësi i sotëm.

Po, Veri është! Leçoja s'grindet dot. Vjen edhe një vagon tjetër, por edhe ai është plot. Përgjegjësi vështron vëngër.

«Hëngsh kokën tënde, që kërkon mananë e sherrin!» — i thotë Pazoja me vete.

Leçoja bën nga fusha e shkarkimit. Andej po vjen elektrovozi me vagonët bosh. Kthehet prapë. Veri merr një vagon bosh e nis drejt galerisë.

— Mbaje aty vagonin, ej! — këlthet Leçoja nga larg.

Veri qëndron i çuditur. «Ç'do ky?!» thotë me sy. Leçoja nxiton.

— Pse s'e pastron vagonin, — thotë që nga larg.

Ende s'e sheh fundin e vagonit. Ndoshta e kishte parë te fusha e shkarkimit kur e sillte elektrovozi dhe s'kishte bërë zë. Priti sa ta merrte njëri nga vagonistët dhe, fap!

— Pse s'e pastron, po të them?! — e ngriti zërin edhe më.

Veri s'bën zë. Në ditët kur është punëtor, Leçoja punon me të. Leçoja minator, Veri vagonist. Po sot tjetër është puna! Leçoja është përgjegjës. Veri s'kundërshton. Përmbys kapakun e vagonit përgjysmë dhe e pastron me lopatë. «Sesi bëhet ky, sesi ngjan kur bëhet përgjegjës», thotë me vete. Por s'do të grindet. «Një ditë është kjo, nesër vjen përgjegjësi dhe Leçoja kthehet punëtor. Si punëtor s'është i keq, dreqi», shton Veri, gjithnjë me vete.

— Këtë vagon s'do t'ia shënosh, more vesh?
— i thotë Leçoja markistit.

— Cilin vagon? — pyet Veri. S'duron dot më.

— Vagonin që do të sjellësh.

— Edhe po të jetë i rregullt?

— Si të duash nxirre! — ngul këmbë Leçoja.

— Po e solli plot, unë s'kam pse t'ia humb!

Në bisedë ndërhyjnë Pazoja.

— Ti zbrit këtu poshtë njëherë! — kapet me të Leçoja.

Pazoja zbret ngadalë-ngadalë. Ashtu siç flet, ashtu dhe ecën.

— E dëgjove që këtë vagon do ta humbësh?

— Secili e di vetë ndrejtimin e punës që ka. Pazoja thotë «ndrejtim» për drejtim.

Leçoja, i kreshpëruar i tëri, tani është si

një copë nerv. 'E vështron markistin në sy nga afër, po s'di ç'ti thotë.

— S'ke faj ti, jo! — shfryn më në fund.

S'është mësuar ta kundërshtojnë në ditët kur është përgjegjës. S'duron dot t'i kundërshtojnë fjalën. Lëviz gjithandej, nga fusha e shkarkimit e gjer në galerinë më të largët. U flet të gjithëve, dikujt i ndihmon në shtytjen e vagonit, një të riu ia merr lopatën nga dora dhe qullet në djersë duke e mësuar si mbahet e si duhet të gjarpërojë ajo në duart e punëtorit, vjen nga balli më i largët me thikat e çekiçit të minatorit që punon atje, ia kalit vetë në forxhë e po vetë ia çon në ballë të galerisë.

Kur e sheh kështu, thua se s'është përgjegjës. Vetëm s'do «ta kundërshtojnë dhe t'i ikin para kohe nga puna. Edhe këtë e ka vdekje! As jep leje, as do t'i ikë njeri pa leje. «Ike? S'ke ditë pune! Edhe qiellin të kesh rrëzuar!»... thotë ai. Sikur do të mohojë atë Leçon punëtor, që fluturon e grindet pse i presin orët kur ikën pa leje.

«Pse s'rri rehat, mor mizë mushke, ë?» — i thotë Pazos me vete, kurse me zë i bërtet:

— Pse i bie së mirës me shkelm? Apo do të të dërgoj të punosh atje brenda?

Brenda thotë për nëntokën. Këtë e ka kot, se Pazaiti s'punon kurrë brenda. As do të punojë 'kurrë. Le të urdhërojë kushdo. Ai ka raport mjekësor. «Punë të lehta, pa sforcime fizike, vetëm në sipërfaqe», thotë raporti mjekësor. Këtë e dinë të gjithë, e di dhe Leçoja, po s'duron dot që Pazoja s'i mban anën.

Pazoja s'i do llafet. Pastaj me Leçon mund të grindesh kur të duash, atë gati e ke, dili përpara kur është përgjegjës dhe të shohësh po s'u grinde!

Pazo markisti ngjitet te vendi i vet, ulet mbi fierin e shtruar dhe hap bllokun. Në fytyrë s'i gjen dot as më të voglën shprehje të humorit. Ai s'tallet me askënd. As me Leçon, as me punëtorët. S'mban anën e asnjërit. Mban anën e të «ndrejtit». Qoftë me këdo e «ndrejta».

Leçoja largohet. Merr llambën e zhduket tej grykës së galerisë, duke i thënë edhe një herë markistit që Verit atë vagonin t'ja humbë.

— Nuk e di, por, po të më bënin mua përgjegjës turni, edhe po të doja, s'do bëja dot si ky Leçoja ynë! — thotë një minator që ka dalë për të pirë cigare jashtë galerisë.

Pazoja, s'i bën zë. Sikur s'është fare aty. Hap çantën e nxjerr një vëshnik rrush. Nis e qëmton atë ngadalë. Kokrra-kokrra. Është aq i shëndetshëm, sa, po ta shohësh, s'e beson për të paaftë. Një i kuq i lehtë si lëng trëndafili sikur i ka larë fytyrën. Dhëmbët i ka të rregullt e të bardhë. Ke dëshirë ta shohësh me shëndetin që ka, por, kur shkon gjatë verës për banja rëre në lumë, veçohet. S'do ta shikojë njeri me ato këmbë që ka. I ka djegur disa vjet më parë, kur punonte në repartin e shkri-rjes. Tani i ka të qepura dhe s'vrapon dot gjatë, nuk përton, por lodhet shpejt. Po të djersijë, këmbët i çajnë e i dhembin. Kishte katër fëmijë kur u aksidentua. Në sektorin e-shkri-rjes s'punonte dot më. E rregulluan për më lehtë si markist.

«Më të lehtat qenkan më të rëndat», tha Pazoja pas një jave punë. Si markist i duhej të grindej, të bënte llafe. Shumicën e rasteve fare kot, por kjo e lodhte edhe më shumë. Një vagonisti i preu gënjeshtren me lapsin e tij të lidhur me fill spangoje. I hoqi disa vagonë, u grind me të me të drejtë, por ai s'i flet me gojë

tani. Vagonët, pas asaj dite, i mbush plot. Sidoqoftë Pazos i duket vetja fajtor. Një ditë ai i ofroi ca rrush. Rrush të zi kokërrmadh. Pazoja s'ia mori. Unë ta jap si shok, i tha tjetri, jo si markist, ta jap si Pazo! Pse s'i jep Merjemes, ti, i tha markisti, duke qeshur, për seleksionuesen. Asaj jepi si shoqe! Por s'ke leverdi tek ajo, kurse Pazoja ta skuq!

Tjetri s'di ç'të thotë.

— Po ndize njëherë, të paktën! — i ofron cigaren.

— Jo! Faleminderit, më rron babai! — ia kthen Pazoja, pa u tërhequr. — Pesë vagonë ke deri tani, je prapa shokëve. Oburra e puno, mos u përdridh andej-këtej, se nuk kalohet jeta e as puna duke përmjerrë! More vesh?! Mora thuaj!

Tjetri ngrihet e ikën, po më i skuquri është Pazoja, markisti. E vret qetësia e tjetrit, e hileqarit. «Përse të jetë kështu, xhanëm, thotë me vete për të, ke parë ti?! E mira me të keqen shkoka për bukuri ndonjëherë. Edhe punëtor i zoti, po të dojë, edhe hileqar!» Markistit i duket e çuditshme që hileqari përpiqet t'ia hedhë përsëri. Më shumë e zemëron tjetër gjë. Njerëz të këtij lloji e detyrojnë të grindet, të shajë e të mallkojë, jo vetëm këmbët që ka, që nuk e lënë të bëjë ç'duhet bërë, por edhe atë fierin e shtruar që e mban butë dhe e bën që të grindet me këta njerëz që punojnë!...

«Mirë që janë të paktë, me kokrra janë këta njerëz...», thotë pastaj, kur qetësohet, kur çdo gjë ecën bukuri e kur atij s'i duhet të flasë e të thotë:

— Ej, pse qan vagoni?!

«Qan vagoni», do të thotë pse s'e ke mbushur plot. «Ja, po të jenë vagonistët si Veri,

Nuriu, Josifi, Serjani, s'ka nevojë fare për markist puna», qeshet ai me vete. «Këta lëri të punojnë, e mos u qaj për ta, se qan veten! Në fund pyeti sa vagonë kanë nxjerrë, dhe sa gënjen lapsi im i vogël, aq gënjejnë ata!...»

Doli prapë Veri e prapa tij Leçoja, sikur ta ndiqte nga pas.

— Pazait!

— Urdhëro, përgjegjës Leçoja! — duke u çuar e duke dashur të nxitojë, sikur bën humor, por askush nuk qesh. Kjo është e përditshme dhe me të përditshmen nuk tallet kush. E përditshmja është jeta...

— Do të punosh ti, apo si e ke hallin? Të ka vënë prapanikja majë, më duket, nga kolltuku i fierit! Rriji punës në këmbë, dëgjove?

— Më gjej një palë këmbë e, po s'i qëndrova si nuse, të më shohësh, o Leço Çeli! Po më pe ulur, mahere po, mahere të më vësh qentë! Mahere po!

Pazoja thotë «mahere» për atëherë.

«Unë vërtet bëj fjalë, thotë me vete, por jo si Leçoja, kot fare, ky grindet me mizat! Or, po dhe me retë e qiellit. Retë i lëviz era! Leçoja grindet edhe pak, pastaj ulet pranë markistit.

— Na, ndize njëherë! — i zgjat cigaren.

— Pak më helmove?! — i thotë Pazoja, por e merr duhanin. «Sesi ndryshon ky Leçoja, thotë me vete, si ajo koha me diell e me shi... Edhe si përgjegjës, kur i shkon puna, s'është i keq. Nesër pasnesër, ku i dihet, mund të bëhet përgjithnjë përgjegjës. Prandaj i rri punës në krye ky, aha... të mora vesh, o Leço Çili, të mora», tha me vete tek dëgjoi ç'po i thoshte përgjegjësi: